



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 2936/1 prot.

Tiranë, më 03.05.2024

UDHËZIM

Nr. 8, datë 03.05 2024

PËR PROCEDURAT E PRANIMIT, TË PEZULLIMIT DHE TË LARGIMIT TË MËSUESIT NGA NJË VEND PUNE, SI DHE ADMINISTRIMIT TË PORTALIT “MËSUES PËR SHQIPËRINË”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky udhëzim rregullon procedurat e pranimit, pezullimit dhe largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
2. Shpallja e vendeve të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”.
3. Portali “Mësues për Shqipërinë” krijohet për punësimin e mësuesve në arsimin parauniversitar, në bazë merite, duke siguruar transparencë, efikasitet dhe shanse të barabarta.
4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) është institucioni përgjegjës për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të mësuesve në një vend të lirë pune në institucionet arsimore parauniversitare publike. Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) organizojnë procedurat sipas këtij udhëzimi.
5. Thirrja për konkurrim shpallet sipas profileve lëndore për mësuesit, sipas Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP).
6. Procesi i konkurrimit për mësuesit, zhvillohet për:
 - a) kandidatin që plotëson kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ushtrimin e profesionit të mësuesit;
 - b) kandidatin që ka marrë pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë” të thirrjes paraardhëse dhe që dëshiron të përmirësojnë rezultatin e tij;

- c) kandidatin që kryen provimin e licencimit, e kalon me sukses këtë provim dhe zgjedh që në të njëjtën ditë të kryejë edhe testimin e informatizuar për të konkurruar për pjesëmarrje në portalin “Mësues për Shqipërinë”.
7. AKAP ka detyrimin të publikojë në portalin “Mësues për Shqipërinë” përgjatë gjithë vitit, vendet e lira të punës për çdo institucion arsimor parauniversitar publik, si dhe listën e punësimeve të kryera në muajin paraardhës brenda 5 (pesë) ditëve të para të çdo muaji. Vendet e lira të punës që krijohen për shkak të mbushjes së moshës për pension pleqërie, publikohen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së daljes në pension të mësuesit.
8. AKAP/DRAP publikojnë në faqet e tyre zyrtare, shpalljen për konkurrim në portalin “Mësues për Shqipërinë”, e cila përmban këto të dhëna:
- profilet lëndore për të cilat do të zhvillohet konkurrimi, si dhe dokumentet që do të vlerësohen në konkurrim;
 - fazat në të cilat do të kalojë konkurrimi, vlerësimi i dosjes dhe testimi i informatizuar;
 - dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;
 - datën e daljes së rezultateve për fazën e vlerësimit paraprak dhe përfundimtar të kandidatëve;
 - mënyrën e vlerësimit të kandidatëve për të gjitha fazat e konkurimit;
 - mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.
9. Regjistrimi i kandidatëve bëhet në e-albania në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Afati për kryerjen e aplikimit dhe ngarkimit të dokumentacionit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes.
10. Kandidati që zhvillon provimin e licencimit në QSHA dhe e kalon atë me sukses, ka të drejtë që në të njëjtën ditë të marrë pjesë edhe në testimin e informatizuar për të konkurruar për pjesëmarrje në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Kandidati që nuk zgjedh të marrë pjesë në testimin e informatizuar në të njëjtën ditë në të cilën jep provimin e licencimit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit, i nënshtrohet procedurave të konkurimit sipas rregullave të parashikuara në këtë udhëzim në rast të konkurimit në portal në thirrjen e radhës.

KREU II

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË DOSJEVE

- AKAP krijon Komisionet e Vlerësimit të Dosjeve (KVD) në nivel rajonal (sipas ndarjes së DRAP-eve).
- KVD përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:
 - 2 (dy) anëtarë nga DRAP, kryetar i komisionit është drejtori i DRAP;
 - 1 (një) anëtar nga AKAP;
 - 2 (dy) anëtarë nga ZVAP në juridiksion të DRAP, nga të cilët të paktën njëri të jetë në profesion mësues.
- Specialisti i burimeve njerëzore dhe juristi në DRAP, kryejnë rolin e sekretariatit teknik për mbajtjen e të dhënave për dokumentet e kandidatëve.

4. KVD kryen këto detyra:

- a) vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati, sipas kritereve të vlerësimit të përcaktuara në shtojcën 1, të këtij udhëzimi;
- b) evidenton kandidatët që mbartin pikët, si dhe rastet kur kandidatët kanë ngarkuar në portal dokumente shtesë;
- c) shqyrton ankesat e kandidatëve për vlerësimin e marrë;
- d) përgatit listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në testimin e informatizuar;
- e) bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra në secilën fazë të vlerësimit dhe ato në total në përfundim të vlerësimit;
- f) dërgon elektronikisht në AKAP dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit listën me renditjen e pikëve për çdo kandidat.

KREU III PROCEDURA E KONKURRIMIT

1. Vlerësimi i kandidatëve përfshin:

- a) Vlerësimin e dosjes deri në 30 pikë;
 - b) Vlerësimin e testit të informatizuar deri në 70 pikë. Për kandidatët që në të njëjtën ditë zhvillojnë provimin e licencimit dhe të testimit të informatizuar, vlerësimi përfshin pikët e testit të licencës dhe pikët e testit të informatizuar, të konvertuara nga QSHA në 70 pikë gjithsej.
2. Në fazën e parë, kandidatët e interesuar regjistrohen në e-albania në portalin “Mësues për Shqipërinë”.
3. Kandidatët për mësues që aplikojnë për herë të parë, në momentin e aplikimit ngarkojnë në portal dokumentet e mëposhtme, të cilat janë të detyrueshme:
- a) kopje të diplomës/ave për ushtrimin e profesionit të mësuesit dhe listës së notave;
 - b) kopje të licencës për ushtrimin e profesionit, për kandidatët që e kanë detyrim ligjor;
 - c) formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, sipas modelit të shtojcës 3, të këtij udhëzimi;
 - d) deklaratë nga kandidati për autorizimin e institucionit arsimor që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura sipas modelit të shtojcës 4, të këtij udhëzimi;
 - e) çdo dokument tjetër që disponon, që sipas shtojcës 1 të këtij udhëzimi vlerësohet me pikë, të cilat nuk janë të detyrueshme.
4. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban një nga dokumentet e detyrueshme sipas pikës 3, të këtij kreu, nuk kualifikohet.
5. Kandidati aplikon në DRAP-in ku ka vendbanimin e përhershëm. Ai ka të drejtë të përzgjedhë deri në tri ZVAP ku dëshiron të punësohet.
6. Kandidati që zotëron më shumë se një licencë, ka të drejtë të konkurrojë në profilet sipas licencave përkatëse.

7. Kandidati që ka qenë pjesëmarrës në portalin e mëparshëm ngarkon në portalin dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu.
8. Kandidati i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e mëparshëm dhe dëshiron të marrë pjesë në testim, do të renditet në listën përfundimtare me pikët e testimit të fundit. Kandidati i cili nuk paraqet dokumente shtesë pranë KVD-s dhe nuk dëshiron të marrë pjesë në testimin e radhës, i mbarten pikët ekzistuese në renditjen e re deri në dy vjet.
9. Kandidati i cili dëshiron të punojë si mësues në dispozicion ose si mësues ndihmës, krahas aplikimit për profilin përkatës, në aplikimin e tij duhet të zgjedhë edhe opsionin “Mësues në dispozicion” ose “Arsim special”.
10. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve firmosin deklaratën për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas modelit të shtojcës 6, të këtij udhëzimi.
11. KVD brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune pas përfundimit të afatit të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e ngarkuar nga kandidatët dhe harton listën emërore për çdo profil, sipas çdo ZVAP-je. Renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës.
12. KVD, dërgon në AKAP listën paraprake të përgatitur si më sipër, për t’u publikuar në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Në të njëjtën ditë që publikohet lista paraprake, KVD njofton në formë elektronike kandidatët e kualifikuar lidhur me vlerësimin e dosjes, si dhe kandidatët që nuk janë kualifikuar dhe arsyen e moskualifikimit.
13. Kandidati ka të drejtën e ankimit në adresën e portalit ose në adresën nga e cila merr njoftimin, brenda 3 (tri) ditëve pune nga dita e shpalljes, lidhur me vlerësimin e dosjes. KVD brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga dita e paraqitjes së ankesës, e shqyrton atë dhe i kthen përgjigje ankuesit, duke reflektuar ndryshimin e pikëve, nëse ankesa ka qenë e drejtë. Pas shqyrtimit të ankesave, AKAP publikon web listën e fazës së parë të vlerësimit të dosjeve.
14. Në fazën e dytë “Testimi i informatizuar”, merr pjesë kandidati që aplikon për herë të parë, i cili në aplikimin online ka zgjedhur opsionin “Aplikoj për herë të parë” dhe ka kaluar me sukses fazën e vlerësimit të dosjeve, si dhe kandidati që ka zgjedhur opsionin “Mbart pikët e dosjes dhe do të marrë pjesë në testim”. AKAP përgatit listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në testimin e informatizuar.
15. Kalendari i testimit të informatizuar hartohet nga QSHA dhe publikohet në portalin “Mësues për Shqipërinë”, si dhe në faqet zyrtare të AKAP, DRAP, QSHA.
16. Kandidati ka të drejtë të paraqesë ankim në QSHA dhe për dijeni në AKAP brenda 3 (tri) ditëve pune, nga marrja e rezultatit të testimit të informatizuar. QSHA në bashkëpunim me ASCAP, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e paraqitjes së ankesës, e shqyrton atë, i kthen përgjigje ankuesit dhe reflekton ndryshimin e pikëve, kur pranohet ankesa.
17. AKAP bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale, që nxirret nga shuma e pikëve të marra në vlerësimin e dosjes së aplikimit dhe pikëve të marra në testimin e informatizuar. Renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës. Lista publikohet në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe në faqen zyrtare të institucionit.

18. AKAP i përcjell njësive të vetëqeverisjes vendore listën me renditjen e kandidatëve për mësuesit e arsimit parashkollor.
19. Kandidati që kryen provimin e licencimit dhe e kalon me sukses këtë provim, ka të drejtë që në të njëjtën ditë të kryejë edhe testimin e informatizuar për të konkurruar për pjesëmarrje në portalin “Mësues për Shqipërinë”.
20. QSHA, brenda 3 (tri) ditëve pune nga përfundimi i sezonit të provimeve të licencimit për profesionin e rregulluar të mësuesit, dërgon në AKAP listën e kandidatëve që kanë kaluar me sukses provimin e licencimit dhe kanë marrë pjesë edhe në testimin e informatizuar për pjesëmarrje në portal, me pikët e fituara sipas parashikimit të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu.
21. Kandidati, i përcaktuar në pikën 19 të këtij kreu, brenda 10 (dhjetë) ditëve, regjistrohet në a-albania në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe ngarkon dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu.
22. KVD brenda 3 (tri) ditëve pune nga përfundimi i afatit, sipas pikës 21 të këtij kreu, bën vlerësimin e dosjeve dhe i komunikon me e-mail çdo kandidati pikët e dosjes. Kandidati kanë të drejtën e ankimit për pikët e dosjeve brenda 3 (tri) ditëve. KVD brenda 2 (dy) ditëve pune shyrton ankesat nëse ka dhe bën njoftimin me e-mail për vlerësimin përfundimtar. Rezultatit përfundimtar të pikëve të dosjeve e dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në AKAP.
23. Për kandidatët e përcaktuar në pikën 19 të këtij kreu, AKAP mbledh pikët e dosjes të me pikët e testimit dhe rendit në listën ekzistuese të portalit, sipas profilit dhe sipas ZVAP-ve, ku kanë paraqitur kërkesën për punësim, si dhe e publikon në faqën zyrtare të institucionit. Një kopje e listës së përditësuar dërgohet DRAP-eve dhe në MAS.

KREU IV

PROCEDURA E ZGJEDHJES SË VENDIT TË PUNËS DHE EMËRIMI I MËSUESVE

1. ZVAP identifikon vendet e lira të punës që krijohen në institucionet arsimore në varësi dhe i dërgon në DRAP me *e-mail* dhe me shkresë zyrtare. Vendet e lira të punës që krijohen në fillim të vitit shkollor dërgohen në DRAP jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga fillimi i vitit shkollor, ndërsa gjatë vitit shkollor dërgohen menjëherë. DRAP raporton vendet e lira të punës në AKAP e cila i shpall ato në portalin “Mësues për Shqipërinë”.
2. Vend i lirë pune do të konsiderohet çdo ngarkesë mësimore, sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin, pavarësisht nëse është në një apo në disa institucione arsimore parauniversitare. Në rast se ngarkesa mësimore është në disa institucione arsimore parauniversitare, mësuesi punësohet në institucionin arsimor ku ka më shumë ngarkesë mësimore.

3. Për vendet e lira të punës për çdo ZVAP, kandidati njoftohet nga KVD në DRAP, në varësinë e të cilit është vendi i lirë i punës. Njoftimi bëhet përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit online.
4. Kandidati i cili është renditur me numrin më të madh të pikëve në profilin që ka konkurruar, ka të drejtën të zgjedh i pari vendin e lirë të punës. Kandidati që nuk paraqitet në thirrjen e organizuar dhe njoftuar përmes postës elektronike nga DRAP ose e refuzon vendin e lirë të punës, mbetet në listën e pritjes me të njëjtat pikë, për një periudhë deri në 2 (dy) vite.
5. Kur dy kandidatë kanë pikë të barabarta, përzgjedhja e vendit të punës bëhet nga kandidati që i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuar (AK) nëse ka të tillë, nëse nuk ka persona me AK, vendi i punës i ofrohet kandidatit që ka pikët më të larta në testimin e informatizuar. Nëse dhe në testimin e informatizuar i kanë pikët e barabarta, përzgjedhja bëhet me short.
6. Kandidati fitues që përzgjedh vendin e punës, pajiset nga DRAP me dokumentin vërtetues për pozicionin e pranuar dhe paraqitet pranë institucionit arsimor parauniversitar, për të lidhur kontratën e punës.
7. Kandidati që përzgjedh vendin e punës dhe punësohet nga institucioni arsimor parauniversitar, me kontratë pune individuale me afat të pacaktuar, hiqet nga lista e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
8. Kandidati fitues punësohet nga drejtori i institucionit arsimor parauniversitar me kontratë pune individuale me afat të pacaktuar, pas kalimit me sukses të periudhës tremujore të provës dhe të vlerësimit pozitiv nga Komisioni për Vlerësimin Psiko-social të Punonjësve Arsimorë dhe punonjësve të tjerë, në institucionet arsimore parauniversitare.
9. DRAP dhe KVD dokumentojnë procesin e përzgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat, si dhe raportojnë me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare në AKAP dhe në MAS, emërimet/refuzimet apo moskonfirmimet e kandidatëve.
10. Kandidati, i cili ka përzgjedhur një vend pune si zëvendësues në profilin përkatës (leje barrë lindje, pezullime etj.), qëndron në atë pozicion deri në përfundimin e kontratës së përkohshme të punës dhe me përfundimin e saj rikthehet në portal, në përputhje me pikët e fituara.
11. Në rast se do të ketë vende të lira pune të cilat do të refuzohen nga të gjithë kandidatët në nivel DRAP-i, këto pozicione u ofrohen kandidatëve të profilit të përafërt me profilin e kërkuar, sipas udhëzimit përkatës të ministrisë përgjegjëse për arsimin, duke respektuar renditjen.
12. Në mungesë të kandidatëve të profilit “Arsim special”, për plotësimin e vendeve të lira për mësues ndihmës, KVD pranë DRAP do të njoftojë të paraqiten për punësim kandidatët nga portali “Mësues për Shqipërinë” të të gjitha profileve, të cilët në aplikim kanë zgjedhur edhe opsionin “Arsim special” duke respektuar renditjen. Këta kandidatë punësohen me kontratë pune me afat deri në përfundim të vitit shkollor, me të drejtë rinovimi të saj, deri në emërimin e një kandidati nga portali të profilit “Arsim special”.
13. Për institucionet arsimore parauniversitare të arsimit të orientuar, në profilet e artit pamor dhe muzikës, si dhe në lëndët e specialiteteve, punësohen kandidatë nga portali, diplomimi i të

cilëve përputhet me kërkesën për vendin e lirë të punës. Këta mësues mund të punësohen edhe në arsimin e mesëm të ulët për lëndët e artit pamor dhe muzikës, sipas renditjes së përgjithshme, me kontrata pune të përkohshme.

14. Të gjithë kandidatët e punësuar, në mungesë të kandidatëve nga portali të profilit përkatës, emërohen me kontratë të përkohshme pune, deri në emërimin e një kandidati të profilit përkatës nga portali. Për këto raste DRAP i drejtohet me kërkesë AKAP-së për miratimin e emërimit të përkohshëm. Këto vende të lira të punës vijojnë të mbeten të publikuara në portal.

KREU V

PROCEDURA E LËVIZJES PARALELE

1. Kur në një institucion arsimor bie numri i orëve mësimore të një profili/lënde, drejtuesi i IAP-së ngre komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë, për të gjithë mësuesit e atij profili/lënde.
2. Komisioni përbëhet nga:
 - a) Drejtori i shkollës (kryetar).
 - b) Një mësues i zgjedhur nga këshilli i mësuesve (anëtar).
 - c) Kryetari i këshillit të prindërve të institucionit (anëtar).
3. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në institucionin arsimor parauniversitar ka për detyrë të bëjë vlerësimin e dosjeve të të gjithë mësuesve me kontratë pune me afat të pacaktuar të profilit/lëndës për të cilën bie numri i orëve, sipas shtojcës 2, të këtij udhëzimi dhe të publikojë në mjediset e institucionit rezultatet e vlerësimit.
4. Vlerësimi i dosjeve në shkollat e bashkuara bëhet për të gjithë mësuesit me kontratë pune me afat të pacaktuar, të arsimit të mesëm të ulët ose të arsimit të mesëm të lartë ku ka rënë ngarkesa mësimore.
5. Drejtori i shkollës përcjell me shkresë zyrtare në ZVAP shtojcën 2 të plotësuar për mësuesin/it që në vlerësimin e dosjeve të kryer nga KVD e shkollës, ka/kanë dalë me më pak pikë dhe ka/kanë ngelur pa ngarkesë mësimore.
6. Mësuesi i punësuar me kontratë pune me afat të pacaktuar, që dëshiron të kryejë lëvizje paralele brenda ZVAP-it ku është i punësuar, brenda muajit qershor ngarkon në portal dokumentacionin sipas shtojcës 2 të këtij udhëzimi.
7. KVD e DRAP, brenda muajit korrik, vlerëson dosjet e kandidatëve që kanë aplikuar për lëvizje paralele sipas pikës 6 të këtij kreu. Rezultatet e vlerësimit paraprak publikohen në faqen e DRAP dhe të ZVAP-së, si dhe i dërgohen me *e-mail* çdo aplikanti.
8. Kandidati që ka aplikuar për lëvizje paralele brenda të njëjtit ZVAP, ka të drejtë të paraqesë ankesë në DRAP për rezultatin paraprak, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e njoftimit të rezultatit.
9. KVD e DRAP, brenda 3 (tri) ditëve pune, shqyrton ankesat dhe i njofton me *e-mail* çdo kandidati rezultatin përfundimtar të vlerësimit të dosjes për lëvizje paralele.

10. KVD e DRAP rendit për çdo ZVAP sipas profileve, mësuesit që kanë ngelur pa ngarkesë mësimore dhe mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele në të njëtin ZVAP. Këto lista i publikon në faqen zyrtare të DRAP, si dhe i dërgon për publikim në ZVAP-in përkatës.
11. Vendet e lira të punës që janë krijuar brenda një ZVAP-je u ofrohen për punësim mësuesëve të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore (lëvizje paralele e detyruar) dhe më pas atyre të cilët kanë aplikuar për lëvizje paralele me dëshirë, sipas profileve dhe renditjes së përcaktuar në pikën 10, të këtij kreu.
12. Në rast se në ZVAP-të e tjera të DRAP-it, rezulton se pas njoftimit për punësim sipas pikës 11 të këtij kreu ka vende të lira pune, atëherë këto vende u ofrohen kandidatëve të papunësuar të të gjitha ZVAP-ve në juridiksion të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore, sipas profileve, duke filluar me kandidatin me më shumë pikë.
13. DRAP njofton AKAP-në në lidhje me punësimet e kryera sipas këtij kreu, e cila i heq nga lista e publikuar këto vende të lira pune.
14. Mësuesit që rezultojnë pa ngarkesë mësimore dhe mbeten të pasistemuar, si pasojë e mungesës së vendeve të lira, u ndërpritet marrëdhënia e punës me të drejtën e konkurrimit sipas këtij udhëzimi.
15. Mësuesit e emëruar nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë” u lind e drejta për të kërkuar lëvizje paralele, pasi të kenë mbushur 2 (dy) vite në të njëjtin vend pune.
16. Për lëvizje paralele mund të aplikojnë edhe mësuesit e kulturës së përgjithshme të institucioneve të arsimit të mesëm profesional që janë punësuar nga portali “Mësues për Shqipërinë” ose para hyrjes në fuqi të udhëzimit për portalin.

KREU VI

PEZULLIMI DHE LARGIMI NGA PUNA I MËSUESIT

1. Drejtori i IAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit në rast se kontaktohet njëri nga rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2/1, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar.
2. Mësuesit të pezulluar i ndërpritin marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit. Masa e pezullimit përfundon me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose të largimit nga detyra. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Drejtori i IAP-së largon mësuesin nga puna, në rast se konstatohet njëri nga rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 2, të nenit 60 dhe shkronjat “a” dhe “b” të nenit 60/1, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar.
4. Përpara marrjes së masave të parashikuara në këtë kre, mësuesit i jepet e drejta për t’u dëgjuar.
5. Largimi nga puna i mësuesit bëhet sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative.

KREU VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra për zbatimin e këtij udhëzimi ruhen në ZVAP dhe në DRAP, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin për arkivat në Republikën e Shqipërisë dhe janë objekt monitorimi dhe inspektimi.
2. Për mësuesit në institucionet parashkollore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e emërimit duke respektuar renditjen në portalin “Mësues për Shqipërinë”.
3. Drejtuesit e DRAP-ve punësojnë si mësues, drejtorë dhe nëndrejtorë në rastet e mëposhtme:
 - a) Kur drejtori apo nëndrejtori i IAP-së jep dorëheqjen.
 - b) Kur në institucionet që ata drejtojnë ulet numri i nxënësve nën normën që përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Drejtorët e DRAP punësojnë si mësues në sistemin arsimor parauniversitar punonjësit e institucioneve në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, të fushës arsimit parauniversitar, të cilët plotësojnë kriteret për të ushtruar profesionin e rregulluar të mësuesit, në rast ristrukturimi, që kanë të paktën 3 vite punë në këto pozicione. Punësimi si mësues bëhet në një institucion arsimor parauniversitar brenda ZVAP-it ku ata kanë paraqitur kërkesën.
5. Në të gjitha rastet e punësimit sipas pikës 3 dhe 4, të këtij kreu, DRAP do të njoftojë AKAP-në, në mënyrë që të hiqet vendi i lirë i punës nga publikimi.
6. Udhëzimi nr. 12, datë 10.6.2021, i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për procedurat e pranimi, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, shfuqizohet.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore rajonale përgjegjëse për arsimin parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTRI

NINA GUGA



SHTOJCA 1

KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË MËSUESIT

1	<p>Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to.</p> <p>Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë. Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë. Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë. Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë. Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë. Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë. Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë. Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë. Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 7 pikë. Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 10 pikë.</p>	0.5-10 pikë
2	<p>Kategoria e kualifikimit:</p> <p>a) Mësues i Kualifikuar (kategoria III) 1-2 pikë (1 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 1.5 pikë për vlerësimin “Mirë”, 2 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>b) Mësues Specialist (kategoria II) 3-4 pikë (3 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 3.5 pikë për vlerësimin “Mirë”, 4 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>c) Mësues Mjeshtër (kategoria I) 5 pikë</p> <p>Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”.</p> <p>Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron. Kandidati që nuk ka kategori kualifikimi vlerësohet me zero pikë.</p>	0-5 pikë
3	<p>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja:</p> <p>a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë. b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 1 pikë. c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë.</p> <p>Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës. Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar.</p>	0-2 pikë

	<p>Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes.</p> <p>Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë.</p> <p>Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.</p> <p>Kandidati që nuk zotëron dëshmi të gjuhës së huaj, vlerësohet me zero pikë.</p>	
4	<p>Trajnime:</p> <p>Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>i. 1 kredit =1 pikë.</p> <p>ii. 2 kredite =2 pikë</p> <p>iii. mbi 3 kredite = 3 pikë.</p> <p>Kandidati që nuk zotëron certifikata trajnimi, vlerësohet me zero pikë.</p>	0-3 pikë
5	<p>Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor.</p> <p>Kandidati që nuk përvojë pune si mësues dhe/ose drejtues institucioni arsimor, vlerësohet me zero pikë.</p>	0-10 pikë (0.5 pikë për çdo vit pune deri në 20 vite punë)

SHTOJCA 2

KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJET PARALELE

1	<p>Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to.</p> <p>Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë. Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë. Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë. Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë. Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë. Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë. Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë. Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë. Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 4.5 pikë. Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 5 pikë.</p>	0.5-5 pikë
2	<p>Kategoria e kualifikimit:</p> <p>a) Mësues i Kualifikuar (kategoria III) 1-4 pikë (1 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 2 pikë për vlerësimin “Mirë”, 3 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe 4 pikë për vlerësimin “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>b) Mësues Specialist (kategoria II) 5-7 pikë (5 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 6 pikë për vlerësimin “Mirë”, 7 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>c) Mësues Mjeshtër (kategoria I) 8-10 pikë (8 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 9 pikë për vlerësimin “Mirë”, 10 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”.</p> <p>Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron. Kandidati që nuk ka kategori kualifikimi vlerësohet me zero pikë.</p>	0-10 pikë
3	<p>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja:</p> <p>a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë. b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 1 pikë. c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë.</p> <p>Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar.</p>	0-2 pikë

	<p>Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë 2 pikë në vlerësimin e dosjes.</p> <p>Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë.</p> <p>Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.</p> <p>Kandidati që nuk zotëron dëshmi të gjuhës së huaj, vlerësohet me zero pikë.</p>	
4	<p>Trajnime. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>i. 1 kredit = 1 pikë.</p> <p>ii. 2 kredite = 2 pikë</p> <p>iii. mbi 3 kredite = 3 pikë.</p> <p>Kandidati që nuk zotëron certifikata trajnimi, vlerësohet me zero pikë.</p>	0-3 pikë
5	<p>Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor.</p> <p>Kandidati që nuk përvojë pune si mësues dhe/ose drejtues institucioni arsimor, vlerësohet me zero pikë.</p>	0-10 pikë (0.5 pikë për çdo vit pune deri në 20 vite punë)
6	<p>Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve (sipas shtojcës 5) .</p> <p>Përfaqësuesit e prindërve të nxënësve, ku mësuesi jep mësim, vlerësojnë punën e këtij mësuesi me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”, si vijon:</p> <p>Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë.</p> <p>Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë.</p> <p>Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë.</p>	0-2 pikë
7	<p>Vlerësimi nga punonjësi/it e shërbimit psiko-social.</p> <p>Punonjësi/it e shërbimit psiko-social vlerësojnë punën e mësuesit me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët” si vijon:</p> <p>Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë.</p> <p>Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë.</p> <p>Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë</p>	0-2 pikë
8	<p>Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, bazuar në vlerësimin e performancës, e shprehur në nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”, si vijon:</p> <p>Vlerësimi: “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë.</p> <p>Vlerësimi: “Mjaftueshëm” = 1 pikë.</p> <p>Vlerësimi: “Dobët” = 0 pikë.</p>	0-2 pikë

SHTOJCA 3

VETËDEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Dokumenti i identifikimit (kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: _____.

i/e padënuar

i/e dënuar

Deklaroj me vullnetin tim të lirë, se nuk kam qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve apo për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me institucionet arsimore, apo i rehabilituar për këto vepra penale.

Emër, mbiemër: _____ Nënshkrimi: _____

SHTOJCA 4

DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë _____, kandidat në procesin e konkurrimit për lëndën/profilin “_____”, të zhvilluar në vitin shkollor _____ - _____, autorizoj DRAP-në _____ të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

AUTORIZUESI



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
INSTITUCIONI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR _____

Nr. _____ prot. _____, më _____.202_

PROCESVERBAL I DOKUMENTIMIT TË OPINIONIT TË KËSHILLIT TË PRINDËRVE
PËR MËSUESIN/EN _____
PROFILI _____,

Sot në datën _____.202_ ora ____:____, bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në udhëzimin nr. _____, datë _____, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, u mbledh Këshilli i Prindërve në shkollën _____ për të dhënë opinion për mësuesin/en, Z./Znj. _____, profili _____, dhe për performancën e tij/saj në procesin mësimor-edukativ, sjelljen dhe etikën në institucionin arsimor.

Në mbledhje morën pjesë _____ prindër nga _____ prindër gjithsej.

Opinionit i prindërve mbi mësuesin/en Z./Znj _____ është:

1. Dobët. 2. Mjaftueshëm. 3. Mirë. 4. Shumë mirë.

Anëtarët e pranishëm në Këshillin e Prindërve:

1. _____ 2. _____ 3. _____

Rezultati i vlerësimit për këtë mësues është: _____

U votua me _____ pro, dhe _____ vota kundër, me votim të fshehtë.

Mbajti procesverbalin

DREJTOR

SHTOJCA 6

FORMULAR DEKLARIMI PËR KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklaruesi: Z./Znj. _____

Pozicioni aktual i punës: _____

Vendi i punës: _____

Unë nënshkruesi _____
(emër, atësia, mbiemër)

Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve për fazën e konkurrimit me dosje për pozicionin e mësuesit në institucionet arsimore parauniversitare publike _____, deklaroj, nën përgjegjësinë time të plotë, se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon legjislacioni në fuqi për konfliktin e interesave.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë ____ . ____ . _____

Nënshkruesi _____
(emër, mbiemër, firmë)